




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. faks Broj stranica Nr. paget	02
Nr. Prot Br. Prot Prot no	03-02/329/17
Data Datum Date	16.10.2017
PRAVOSTITË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 16.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-2541/17, për zyrtarin e lartë z. Ensar Kadriu, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2541/17,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ensar Kadriu, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Ensar Kadriu, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit figuron si pronar dhe Anëtar i Bordit në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkresë z. Ensar Kadriu ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtaret e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.



Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z. Ensar Kadriu zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet qe posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Ensar Kadriu, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka pasur njohuri që është emëruar si Drejtor dhe anëtar i bordit në biznesin K.F.-Gjilan-sh.a, kjo kompani është regjistruar por asnjë herë nuk ka qenë aktive, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëj ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas këtij takimi nga z. Ensar Kadriu, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Ensar Kadriu nuk figuron me si Drejtor i Bordit e as si Drejtor Sportiv në biznesin privat me emër "K.F-Gjilani" Sh.a.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra, nga zyrtari i lartë z. Ensar Kadriu, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si anëtar i Bordit dhe Drejtor Sportiv biznesin privat janë krijuar rrëthana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë lartë z. Ensar Kadriu, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Gjilanit, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

